

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR MOISIU”,

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Universitetin “Aleksandër Moisiu” me objekt “Për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare”, për periudhën 01.01.2013 deri 30.06.2014, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 170, datë 18.12.2014.

Në mbështetje të nenit 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 847/7, datë 18.12.2014, dërguar z. Mit'hat Mema, Rektor i Universitetit “Aleksandër Moisiu”, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtëme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME DHE PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

1. Nga grupi i auditimit u konstatua tejkalim i ndjeshëm i ngarkesës mësimore vjetore nga stafi akademik. Duke pasur në konsideratë që udhëzimi i MAS nr. 20, datë 09.05.2008, lejon kryerjen deri në 30 për qind, rezulton se është evidentuar një nivel ngarkese e tejkaluar më shumë se 100% të ngarkesës. Tejkalmi i normës vjetore, për mësimdhënien është paguar në masën e plotë në të gjitha fakultetet e UT-së, me urdhër të rektorit, në mbështetje të miratimeve nga ish Ministria e Arsimit dhe Shkencës sot Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Nga auditimi u konstatuan edhe tejkalim i ndjeshëm i normës mësimore javore prej 6 orësh në javë, kështu konstatuam raste të ngarkesave mesatare javore deri në 18 orë në javë (ndërkohë që një ngarkesë e tillë është e pajustificuar edhe nga pikëpamja e mundësive njerëzore për tu realizuar). Kjo ngarkesë lëviz nga fakulteti në fakultet. Këto të dhëna tregojnë për përdorim jo efektiv të burimeve njerëzore, planifikim jo të drejtë dhe gjithashtu neglizhencë në monitorim nga ana e drejtuesve të këtyre fakulteteve të realizimit të orëve mësimore, mungesë totale e sistemeve të kontrollit.

Këto tejkalime të ndjeshme të orëve suplementare të mësimdhënies vjetore natyrshëm komprometojnë performancën e mësimdhënies. Ngarkesa e mësimdhënies në kohë suplementare është më e lartë se sa ngarkesa e mësimdhënies me ngarkesë normale, ndërkohë që këto raporte duhet të qenë ndjeshëm në favor të kësaj të fundit.

Në referencë të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 20, datë 9.5.2008 “Për veprimtarinë e Personelit Akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, i ndryshuar ku cilësohet se “*Personeli akademik me kohë të plotë në ILA publike, mund të tejkalojë normën vjetore për mësimdhënien deri në masën 30%, pasi të ketë plotësuar të gjitha detyrimet e kohës vjetore të punës*” dhe situatës së njëjtë të konstatuar në të gjitha Universitetet e audituara në vitin e fundit, ku për shkak të ngarkesës Ministria është detyruar të miratojë gjithmonë propozimet e Universiteteve për pagesën e plotë të mbingarkesave pa analizuar shkaqet e këtyre mbingarkesave. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të bëhet ndërhyrja e duhur në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 20, datë 9.5.2008 “Për veprimtarinë e Personelit Akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, të ndryshuar, për aspekte të veprimtarisë së personelit akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, që ti prihet rruga përdorimit jo të drejtë të stafit akademik dhe përdorimit joefektiv të fondeve në dispozicion të buxhetit të universiteteve publike, ndërhyrje që duhet të paraprihet nga analiza e situatës lidhur me nivelin e lartë të mbingarkesave të raportuara (realizuara), shkaqet të cilat jo gjithmonë lidhen me numrin e madh të studentëve, por me planifikim dhe menaxhim jo të kujdesshëm të stafit akademik në dispozicion dhe tendencës për të hapur/mbajtur programe studimi të cilat nuk mbulohen dot

me kapacitete njerëzore.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE.

Nga auditimi në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm kemi konstatuar se:

1. a Për vitin 2013 pyetësi i vetëvlerësimit është hartuar, plotësuar dhe dërguar me shkresat nr. 1638/1, datë 17.12.2013 dhe nr. 17869, datë 26.11.2013, në respektim të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010. Dokumenti nuk është shoqëruar me deklaratën dhe raportin e cilësisë, në kundërshtim me nenin 18 të po këtij ligji. Gjithashtu konstatuam se përgjigjet nuk janë në përputhje me shkresat e miratuara dhe dërguara në Ministri të Financave dhe Ministri të Arsimit dhe Sportit, dhe gjithashtu nuk janë në përputhje me organigramën e institucionit të vendosur në faqen zyrtare të këtij institucioni.

1. b U konstatua se struktura për staf akademik paraqitet gjatë periudhës objekt auditimi me vende vakant, të pa plotësuara, dhe kjo ka çuar në domosdoshmërinë e marrjes në punë të një numri të madh të stafëve me kontratë (të cilët referuar legjislacionit në fuqi e kanë të limituar numrin e orëve të mësimdhënies) dhe për rrjedhojë plotësimi i nevojave për orë mësimdhënie, kryhet nga stafet akademike të emëruar, të cilët në shumë raste kapërcejnë logjikën e realizimit real të këtyre orëve.

1. c Në UAM Durrës nuk është i qartë, funksioni i menaxhimit të riskut sipas kontekstit të ligjit, megjithëse është hartuar në mënyrë të detajuar regjistri i riskut ku janë identifikuar risqet përkatëse për çdo sektor. Gjithashtu nga universiteti nuk ka një strategji risku të miratuar.

1. d Në drejtim të Aktiviteteve të Kontrollit janë konstatuar se ka mangësi në institucion, në periodicitetin e raportimit dhe monitorimit sidomos për ecurinë dhe realizimin e fondeve buxhetore. Këto raporte nuk duhet të jenë vjetore, por dhe tremujore (raporte monitorimi në zbatim të ligjit) të cilat duhet të bëhen jo vetëm për raportim, por pjesë e analizave financiare dhe për rrjedhojë e analizave të realizimit të objektivave të planifikuara.

Në referencë të këtyre konstatimeve dhe sidomos të faktit që shumë aspekte të menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk njihen plotësisht dhe nuk kuptohen si dhe faktit që plotësimi i pyetësorëve lidhur me MFK bëhet formalisht me gabime dhe vlerësime jo reale.

Për këtë është rekomanduar që:

Nga UAMD duhet që në deklarin e radhës për vitin 2014, për institucionet përkatëse, në plotësim të kërkesave ligjore, të dorëzohet pyetësi i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit së bashku me deklaratën dhe raportin e cilësisë. Gjithashtu nga universiteti të hartohet strategjia e riskut referuar risqeve të realizimit të objektivave, të identifikuara aktualisht.

Deri në 31 dhjetor 2014

Ky proces të shoqërohet edhe me trajnimin e stafit për të njohur dhe kuptuar kërkesat për ngritjen dhe sigurimin e sistemeve të integruara të MFK në institucion, element i rëndësishëm për një mirëqeverisje institucionale.

Në vazhdimësi

2. Është konstatuar tejkalim i ndjeshëm i ngarkesave mësimore vjetore nga stafi akademik. Kemi gjetur raste kur ngarkesa mesatare javore arrinte deri në 18 orë në javë nga 6 orë që është minimumi i lejuar. Nga ana tjetër konstatohet se po të vihen në raport orët e leksionit

dhe seminareve të realizuara nga gjithsecili me javët në të cilët zhvillohen këto orë (30 javë mësimore), numrat dalim me presje dhjetore duke na çuar në logjikën e thjeshtë që ka gabime apo pasaktësi në deklaratimet e orëve mësimore. Në fakultetin e biznesit kemi konstatuar se ka pedagogë me ngarkesë deri në 18 ore. E njëjta situatë shfaqet edhe në fakultetet e tjera. Gjykojmë se këto tejkallime të ndjeshme të orëve suplementare të mësimdhënies vjetore natyrshëm komprometojnë performancën e mësimdhënies. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të merren masa për të ngritur një sistem kontrolli dhe monitorimi të ngarkesës mësimore të çdo pedagogu të universitetit si dhe të ketë një planifikim të kujdesshëm të ngarkesave bazuar në një vlerësim real të mundësive fizike për të përballuar këtë nivel mësimdhënie. Ndërkohë të merren masa që të zbatohet plotësisht Udhëzimi nr. 20, datë 9.5.2008 “Për veprimtarinë e Personelit Akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, i ndryshuar ku cilësohet se “*Personeli akademik me kohë të plotë në ILA publike, mund të tejkalojë normën vjetore për mësimdhënien deri në masën 30%, pasi të ketë plotësuar të gjitha detyrimet e kohës vjetore të punës*”

Në vazhdimësi

3. U Konstatua se në vitin akademik 2012 – 2013 rezulton se janë regjistruar 13,541 studentë, nga të cilët 82% e studentëve janë të nivelit bachelor (me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme). Niveli i studentëve në ciklin e dytë është e njëjtë si për masterin shkencor dhe atë profesional. Evidentohet cikël studimi me 2 studentë. Ka një numër të konsiderueshëm studentësh në ciklin e parë të studimit në Fakultetin e Peshkopisë, cilësojmë se 26% e tyre janë në ciklin me kohë të pjesshme. Nuk jemi përqendruar në analizën e vendimmarrjes kosto përfitim për degët dhe fakultetet që mbahen nga ky Universitet për shkak të kornizës së ngushtë të misionit të këtij auditimi, por nisur nga leximi i numrave për numrin e studentëve dhe kapaciteteve njerëzore në dispozicion. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga ana e universitetit të bëhet një analizë e plotë e mundësive që ka institucioni për të përballuar mësimin në ciklet e studimit dhe degët e tij dhe të mbahen ato degë dhe ai numër studentësh që i përgjigjen këtyre kapaciteteve duke synuar në këtë mënyrë edhe rritje të cilësisë së mbulimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Brenda tremujorit të parë të vitit 2015

4. Është konstatuar se Universiteti që nga viti akademik 2009-2010, është shtrirë edhe në ciklin e tretë të studimeve. Konstatuam se pavarësisht kohës së shkurtër në këtë cikël janë të regjistruar 98 studentë. Gjithashtu janë konstatuar se në fakultetin ku është hapur ky cikël studimi janë në dispozicion vetëm 3 pedagogë me tituj që mbikëqyrin 98 studentë të shkollës së doktoraturës. Në gjykimin tonë ky nivel pedagogësh me tituj dhe grada (19%) e stafit akademik, nuk justifikon hapjen e studimeve në ciklin e tretë me një numër të konsiderueshëm për kapacitetet akademike që kanë. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga ana e Universitetit të analizohen shifrat dhe faktet e cilësuar në këtë raport auditimi, të merren masa që të reduktohen ndjeshëm studentët që ndjekin studimet në ciklin e tretë, pasi rritja e sforcuar sjell rënie të nivelit të kërkimit shkencor dhe deformim të kërkuesve të ardhshëm të kësaj fushe.

Brenda tremujorit të parë të vitit 2015

5. Nga auditimi i pasqyrave financiare të paraqitura për vitin 2013 u konstatua se një pjesë e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara, projekte me vlerë 28,569,701 lekë, janë pasqyruar zë më vete dhe nuk janë përfshirë në vlerën e aktivitetit të qëndrueshëm të trupëzuar, aktiv që

rezulton të jetë marrë në dorëzim, në kundërshtim ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar.

Për këtë është rekomanduar që:

Të bëhen saktësimet kontabël, në mbylljen e vitit ushtrimor duke paraqitur me saktësi vlerën prej 28,569,701 lekë të projekteve në zërin e aktiveve të trupëzuara

Shkurt 2015

6. Nga auditimi është konstatuar se nga ana e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës janë paguar detyrime të kontratës së lidhur për furnizimin me energji elektrike, për nevoja të ndërtimit të kampusit të ri universitar në sektorin Spitallë Durrës. Referuar faktit që këto pagesa janë kryer në kundërshtim me nenin 28 të kontratës së ndërtimit me nr. 1011, datë 17.11.2011 me objekt “ Ndërtimi i kampusit të ri universitar për UAMD” dhe nenit 28 të kontratës nr. 910/6 datë 24.01.2013 lidhur me subjektin përkatës, si dhe për efekt të bërjes transparente të pagesave. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga ana e Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës të bëhet transferimi i Kontratës së furnizimit me energji elektrike, subjektit të ndërtimit të kontraktuar. Ky veprim të kryhet paralelisht me arkëtimin e shumave të paguara padrejtësisht.

Menjëherë

7. Nga auditimi është konstatuar se për periudhën objekt auditimi, nga ana e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës janë paguar detyrimet për kontratën e furnizimit me ujë të Filialit të Peshkopisë, por këto detyrime paraqiten me kuota fikse (300 m³/muaj) dhe jo sipas leximeve të sahatit të instaluar nga kjo ndërmarrje (trajtuar më hollësisht në faqen 32 të projektraportit). Për efekt të kryerjes së pagesave sipas konsumeve faktike në përputhje me rregullat në fuqi dhe për të shmangur abuzivitetin e faturimit të pa drejtë. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga UAMD dhe ndërmarrja “ [REDAKTUAR] ” SHA të kryhet rakordimi midis m³ të faturuar dhe m³ gjendje të sahatit të matjes për kontratën e furnizimit me ujë. Në kushtet e sahatit jashtë normave teknike, brenda rregullave në fuqi, të kryhen veprimet përkatëse dhe të dalë përgjegjësia për punonjësit e këtij filiali të ngarkuar për ndjekjen e kryerjes së shërbimeve

Menjëherë

8. Nga auditimi për periudhën objekt auditimi është konstatuar se, nga ana e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës janë paguar detyrimet për shërbim postar mbi bazën e faturave të lëshuara nga Posta Shqiptare, në një kohë që këto fatura shpesh herë nuk paraqisnin sasinë e shërbimit dhe çmimin për njësi shërbimi dhe njëkohësisht pa u kryer konfirmimi për saktësinë e sasisë së shërbimit nga punonjësit e Arkiv-Protokollit të UAMD. Për efekt të shmangies së pagesave për shërbime të pa kryera. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga sektori i financës së universitetit referuar udhëzimeve të Ministrisë së Financave në fuqi për zbatimin e buxhetit dhe për një menaxhim sa më efektiv të fondeve buxhetore, kryerja e pagesave të bëhet vetëm mbas sigurimit të dokumentacionit vërtetues të realizueshmërisë të kryerjes së shërbimit

Menjëherë

9. Nga auditimi i dokumentacionit argumentues bashkëlidhur pagesave, në procesin e kryerjes së shpenzimeve për kthimin e tarifave, bursave, vendime gjyqësore, etj janë konstatuar mangësi. Për efekt të kryerjes së këtij procesi me përputhshmëri të kërkesave ligjore dhe akteve në fuqi. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga zyra e financës, afati i kthimit të tarifave të studentëve, të cilët për efekte të procedurave që ka vendosur UAMD i kanë paguar ato në fillim të vitit, por që referuar akteve ligjore në fuqi dhe dokumentacionit të paraqitur përfitojnë rimbursim, të bëhet brenda afatit kohor maksimal të vendosur për pagesën e tyre me vendim të Këshillit të Ministrave.

Çdo dokument justifikues bashkëlidhur urdhër shpenzimit duhet të jetë origjinal dhe për efekt të transparencës, dokumenti origjinal i paraqitur në Zyrën e Arkiv-Protokollit për Vendimet Gjyqësore, kërkesa e studentëve së bashku me dokumentacionin argumentues të kërkesës për bursa apo rimbursim tarife shkollimi, etj, duhet të jetë pjesë e praktikës së urdhër shpenzimit.

Vazhdimisht

10. UAMD ka lidhur kontratë një vjeçare për dhënien me qira të një trualli me sipërfaqe 200 m² me një subjekt privat, e cila shtrihet gjatë vitit 2013–2014. Me hyrjen në fuqi të VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë, apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, institucionet, ndërmarrjet, shoqëritë shtetërore, nuk mund të japin me qira vetëm “truall të lirë” me sipërfaqe deri në 200 m². Për këtë arsye, në zbatim të këtij vendimi. **Për këtë është rekomanduar që:**

UAMD, me përfundimin e afatit të kontratës së qirasë, të mos përsërisë dhe të mos lidhë kontratë të re për dhënien me qira të truallit në pronësi të saj me asnjë subjekt privat, ose shtetëror.

Në përfundim të kontratës së qirasë.

11. Nga auditimi i pagesave për paga dhe shpërblime u konstatua se gjatë periudhës objekt auditimi, është bërë ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për dy ish punonjës të cilët kanë qenë pushuar nga puna, [REDAKTUAR], ka përfituar dëmshpërblim në shumën 1,116,972 lekë dhe [REDAKTUAR], ish punonjës, ka përfituar përfituar dëmshpërblim në shumën në masën e 5 pagave mujore në shumën 363,765 lekë. Vlera prej 1,480,728 lekë, përbën shpenzim joefektiv për buxhetin e UAMD. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të analizohet përgjegjësia institucionale dhe të kërkohet kthimi në buxhetin e universitetit i shumës **1,480,728 lekë** nga personat përgjegjës që nuk kanë ndjekur dhe mbrojtur veprimet administrative të institucionit.

Menjëherë

C. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjatë auditimit të pagesës së orëve suplementare të realizuara gjatë vitit akademik 2012–2013 në mbingarkesën e deklaruar, evidentohet pagesa e stafit akademik për 13,412 orë mësimore të konvertuara, me vlerë 8,500,000 lekë, për provime të korrigjuara në tre sezonet e provimeve, në kundërshtim me ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në RSH” i ndryshuar dhe akteve dalë në zbatim të tyre. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të kontabilizohet dhe të kërkohet kthimi në buxhetin e universitetit i shumës **8,500,000 lekë** nga personat përgjegjës që kanë për detyrim ti menaxhojnë dhe monitorojnë këto fonde dhe që kanë lejuar përdorimin jo efektiv të tyre.

Menjëherë

2. Gjatë auditimit të procedurës së zhvillimit të tenderit me objekt “Sistemim i jashtëm i objektit të ri 6 katesh të kampusit universitar” i zhvilluar në vitin 2013, u konstatua se shoqëria e projektimit [REDAKTUAR], në cilësinë e hartuesit të projektpreventivit:

Ka përfshirë në preventiv zëra punimesh me vlerë **3,138,660 lekë**, të cilët janë pjesë e shpenzimeve të përgjithshme në strukturën e kostos, duke rritur padrejtësisht vlerën e preventivit, në kundërshtim me Kreu-ⁿ e II/B të UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

Ka kryer llogaritje të gabuara me vlerë **499,574 lekë** në zërin e punimeve “Beton M 200 për realizimin e kunetave anësore të rrugëve”, e cila nuk përputhet me projektpreventivin përkatës.

Në preventivin e hartuar, në një rast ka vendosur çmim më të lartë, me efekt rritjen e vlerës së preventivit me **156,210 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 407, datë 27.6.2012, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”.

Në strukturën e kostos, në preventivin e punimeve ka përfshirë vlerën e pajisjeve dhe aparaturave me efekt në rritjen e vlerës së padrejtë të preventivit me **80,600 lekë**, cila përfaqëson vlerën e TVSH dhe fondit rezervë, në kundërshtim me pikën A/7 të UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

Për këtë është rekomanduar që:

Të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **3,875,044 lekë**, nga shoqëria që ka përgatitur projektpreventivin.

Menjëherë

3. Nga auditimi i veprimeve të kryera me bankë u konstatuan pagesa me vlerë **525,600 lekë**, për *14 punonjës të UAMD*, e cila përfaqëson pagesa të kryera gjatë vitit 2014 për pjesëmarrje në borde etj, ndërkohë që personat përfitues nuk kanë qenë prezent në këto borde, veprim që bie në kundërshtim me VKM nr. 418, datë 27.06.2012 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të Këshillave, Bordeve, ose Komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore”. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **525,600 lekë**, përfituar padrejtësisht nga *14 punonjësit e UAMD*.

Menjëherë

4. Komisioni i blerjeve me vlera të vogla i përbërë nga [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] ka kryer blerje për “pjesë ndërrimi” për automjete me vlerë **463,600 lekë**. Pjesët e blera nuk janë të vlefshme për automjetin që ka gjendje UAMD. Blerja nuk është e shoqëruar me kërkesën për domosdoshmërinë e tyre, procesverbalin për defektet e konstatuara dhe nuk ka procesverbal për riparimin e mjetit. Në tërësi veprimet e kryera janë në kundërshtim me urdhrin e APP nr. 33, datë 11.7.2013 “Për gjurmët e auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **463,600 lekë**, nga anëtarët e komisionit të blerjeve me vlera të vogla.

Menjëherë

5. Nga auditimi i veprimeve të kryera me bankë, u konstatuan pagesa me vlerë **prej 463,000 lekë**, ku **212,000 lekë për vitin 2014 dhe shuma 251,000 lekë për vitin 2013**, për udhëtim e dieta të përfituara nga punonjësit e UAMD, të cilat përfaqësojnë pagesa të kryera për mësimdhënie nga punonjësit e stafit akademik të UAMD në ditët jo zyrtare të punës, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që

dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **463,000 lekë**, nga punonjësit përfitues.

Menjëherë

6. Këshilli i Administrimit të UAMD ka miratuar dhe dërguar jashtë shtetit për trajnim tre studentë, duke i përballuar vet shpenzimet për udhëtim e dieta në vlerën **332,589 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 870, datë 14.2.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, ku në shumën 73,689 lekë janë paguar dieta nga data 2-9 prill 2014 nga 25 euro në ditë për student, paguar 162,120 lekë biletë avioni vajtje ardhje dhe figuracion, si dhe shuma 96,780 lekë shpenzime akomodimi për studentet e degës informatikës. Bazuar në dokumentacionin e venë në dispozicion, shpenzimet e cilësuar nuk janë të mbështetura ligjërisht dhe për këtë arsye përbëjnë dëm ekonomik. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **332,589 lekë**, nga anëtarët e Këshillit të Administrimit me përbërje sipas listës bashkëlidhur raportit.

Menjëherë

7. UAMD ka dhënë me qira një sipërfaqe trualli prej 200 m². Nga verifikimi dokumentacionit u konstatua se çmimi i vendosur në kontratën lidhur midis palëve ishte më i ulët, nga sa përcakton VKM-në nr. 529 datë 08.06.2011 kreun III “Tarifat dhe vlera dysHEME për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enFiteozë” i shoqëruar me efekt negativ në të ardhurat e UAMD prej **168,000 lekë**, të cilat janë përfituar nga subjekti [REDAKTUAR]. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **168,000 lekë**, nga subjekti përfitues [REDAKTUAR].

Menjëherë

8. Hartueset e dokumenteve të tenderit me objekt “Sistemim i jashtëm i objektit të ri 6 katesh (nr. 1) të kampusit universitar” kanë përfshirë me iniciativë në strukturën e kostos, në preventivin e punimeve edhe vlerën e pajisjeve, me efekt në rritjen e padrejtë të vlerës të preventivit me **65,600 lekë**, cila përfaqëson vlerën e TVSH dhe fondit rezervë, në kundërshtim me pikën A/7 të UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **65,600 lekë**, nga hartueset e dokumenteve të tenderit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], ose nga 21,667 lekë/secila.

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE.

Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalin nr. 1, datë 28.10.2014 dhe nr. 2, datë

27.10.2014, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenin 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” të ndryshuar, pikës 3, kreu X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, neni 7, pika 2,3/a, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, i **rekomandojmë Drejtorit të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për personat si më poshtë:

- 1.Zj. [REDAKTUAR] në cilësinë e juristes në grupin e hartuesve të dokumenteve të tenderit,
- 2.Zj. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtares në grupin e hartimit të dokumenteve të tenderit,
- 3.Zj. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtares në grupin e hartimit të dokumenteve të tenderit,
- 4.Z. [REDAKTUAR], në cilësinë e kryetarit të Komisionit të vlerësimit të ofertave,
- 5.Z. [REDAKTUAR]
- 6.Z. [REDAKTUAR]
- 7.Zj. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtarëve, të Komisionit të vlerësimit të ofertave,

për tenderin me objekt prokurimi “Sistemim i jashtëm i objektit të ri 6 katesh (nr. 1) të kampusit universitar” me vlerë të preventivuar 65,700,00 lekë:

Hartueset e dokumenteve të tenderit kanë vendosur *Kriteret e veçanta të kualifikimit* në kundërshtim me: Nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Pikën 3/a/c të Kreu¹ të III të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar.

Është kërkuar që operatorët ekonomikë të kenë në licencë kategori të punimeve për zëra punimesh të cilat *nuk përmbahen në preventivin e punimeve të objektit dhe/ose janë ndjeshëm mbi vlerën e punimeve të parashikuara në preventiv, janë kërkuar makineri dhe të punësuar me profesion, që nuk kanë lidhje me punimet që do të kryhen.*

Hartuesit e dokumenteve të tenderit, me kriteret e vendosura, kanë tejkaluar ndjeshëm kufizimet ligjore, në dëm të sigurimit të mirëpërdorimit të fondeve publike, të nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e konkurrimit, trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues, për të gjithë operatorët ekonomikë etj, të cilat e kanë kompromentuar tërësisht procesin e konkurrimit të ndershëm etj.

Komisioni i vlerësimit të ofertave, në procesin e vlerësimit dhe kualifikimit të dokumentacionit të OE, ka përdorur standard të dyfishtë. Për të njëjtat parregullsi në dokumentacion, ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE me ofertë më të lartë, ndërkohë që duhet të anulonte dhe të përsëriste procedurën e tenderit.

Në vlerësim të përbashkët, praktikisht, hartuesit e dokumenteve të tenderit me kriteret e vendosur dhe KVO me argumentimin, standardin e përdorur në kualifikimin/skualifikimin e OE pjesëmarrës në tender, kanë paracaktuar shoqërinë fituese, në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi i ligjit” dhe nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT